




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjilanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjilan
Gilan Belediyesi

Në bazë të Rregullores Komunale për Ndarjen e Bursave për Studentët e Komunës së Gjilanit, Nr. 03/2021, neni 4 si dhe Vendimit të Kuvendit të Komunës së Gjilanit, 01 Nr. 016-103262 i datës : 28.09.2023, Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilan, shpallë :

KONKURS PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTËT E KOMUNËS SË GJILANIT

- Sipas këtij konkursi, ndahen njëqind e nëntëdhjetë e dy (192) bursa për studentët e Komunës së Gjilanit, për vitin akademik 2022/2023, (për afatin kohor : 01.09.2022 deri më : 30.06.2023).
- Njëqind e gjashtëmbëdhjetë (116) bursa në vlerë prej 60 euro, për çdo muaj për afatin kohor : 01.09.2022 deri më : 30.06.2023, ndahen për studentët e studimeve themelore të Komunës së Gjilanit, të cilët studiojnë në Universitetet e Kosovës, jashtë Komunës së Gjilanit;
 - Gjashtëdhjetë e gjashtë (66) bursa në vlerë prej 40 euro, për çdo muaj për afatin kohor : 01.09.2022 deri më : 30.06.2023, ndahen për studentët e studimeve themelore të Komunës së Gjilanit, të cilët studiojnë në Universitetet brenda Komunës së Gjilanit.
 - Dhjetë (10) bursa në vlerë prej 40 euro, për çdo muaj për afatin kohor : 01.09.2022 deri më : 30.06.2023, ndahen për studentët e studimeve Master.

Kriteret e Përgjithshme dhe të veçanta për të fituar bursën:

- Shfrytëzues të bursave mund të jenë vetëm studentët me vendbanim të përhershëm në Komunën e Gjilanit;
- Shfrytëzues të bursave studentore mund të jenë vetëm studentët e rregullt;
- Shfrytëzues të bursave studentore mund të jenë vetëm studentët e rregullt me notë mesatare nga 7.0;
- Bursat do të ndahen vetëm për studentët që kanë mbaruar një vit e më shumë të studimeve;
- Nuk mund të jenë përfitues të bursës më shumë se një student (aplikues) nga familja e ngushtë.

Kriteret e veçanta për të fituar bursën dhe poentimi :

- Studentët të cilët studiojnë në Universitetet Publike1 pikë
- Nota mesatare - poentimi bëhet mbi bazën e notës mesatare.....
- Studentët të cilët janë fëmijë të dëshmorëve dhe veteraneve të UÇK-së.....1 pikë
- Familjet që kanë tre (3) studentë e më tepër të rregullt1 pikë
- Studentët me gjendje të vështirë ekonomike.....1 pikë
- Studenti/ja i cili nuk i ka dy prindërit në jetë.....2 pikë
- Studenti/ja i cili nuk e ka njërin nga prindërit në jetë.....1 pikë

Dokumentet e Nevojshme për Aplikim:

- 1.Certifikata e notave (originale);
- 2.Certifikata mbi vendbanimin e përhershëm;
- 3.Kopja e letërnjoftimit;

6. Dëshmi se familja i ka 3 studentë në studime të rregullta;
7. Dëshmi për gjendjen e vështirë ekonomike (vërtetimi i asistencës sociale apo ndonjë dëshmi tjetër për gjendjen e vështirë ekonomike);
8. Dëshmi se studenti/ja nuk i ka dy prindërit apo njërin në jetë.
9. Kopjen e xhirollogarisë bankare e konfirmuar nga banka përkatëse.

Të gjitha dokumentet e kërkuara për aplikim do të konsiderohen valide nga momenti i shpalljes së konkursit të bursave.

Konkursi mbetet i hapur për aplikim 15 ditë nga dita e shpalljes në ueb faqen e Komunës si dhe në mjetet e tjera të informimit publik.

Të gjithë studentët e interesuar duhet t'i marrin aplikacionet dhe të plotësuara me dëshmitë e kërkuara të dorëzohen pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në kuadër të Drejtorisë për Administratë e Përgjithshme në Gjiilan.



Drejtori i Drejtorisë së Arsimit

Albana Demiri